



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.79/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Laziç dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në hapsira publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 28.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa ZL.Anr.79/2017 e datës 26.09.2017, e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dega në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 26.09.2017 në rrugën “Zahir Pajaziti”, në afërsi të tregut të gjelbërt në Prizren, monitoruesit e KDI-së kanë hasur në një poster të kandidatit për kryetar të komunës nga radhët e subjektit politik PDK, të ngjitura në një objekt banesor, pra në hapsira publike.

Me këtë rast sipas pretendimit në ankesë thekson se subjekti politik PDK ka bërë shkelje të dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur katër fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 27.09.2017, subjekti politik PDK, thekson se lidhur me vendosjen e posterëve për kandidatë për kryetar të komunës në Prizren, në një objekt banesor, duke shtuar se PZAP-in e njoftojmë se vendosja e panos është bërë me pëlqimin e pronarit të Sfringa sh.p.k, duke u bazuar në kontratën mbi qeranë, për shfrytëzimin e muraleve e lidhur në mes të pronarit privat Sfringa sh.p.k dhe Komunës së Prizrenit. Si dëshmi ka bashkangjitur kontratën e sipërcekur të datës 25.05.2017 .

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesë lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye se vendosja e panove në objektin privat është bërë me pëlqimin paraprak të pronarit të objektit, në bazë të kontratës mbi qeranë, për shfrytëzimin e muraleve e lidhur në mes të pronarit privat Sfringa sh.p.k dhe Komunës së Prizrenit.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.79/2017 më datën 28.09.2017.

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sytejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.